



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:164338

Datë: 19.06.2024

Numri i dokumentit: 05834212

C.nr.624/20

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, me gjyqtarin Robert Tunaj dhe sekretaren juridike Fitnete Kabashi, në çështjen kontestimore të paditësit KEDS Sh.a me seli në Prishtinë të cilën me autorizim e përfaqëson G. H, kundër të paditurit N. Rr. E nga S. me objekt kontesti kompenzim dëmi, në seancë gjyqësore , me datën 19.06.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

(Në bazë të Heqjes Dorë nga Kërkesëpadia)

Refuzohet kërkesëpadia e paditësit KEDS Sha me seli në P , kundër të paditurit N. E nga S , me të cilën ka kërkuar “ të obligohet paditësi të kontesti kompenzim dëmi, në vlerë 8104.80 € me kamat ligjore dhe të obligohet i padituri të paguajë shpenzimet procedurale në shumë 60,00€ ”

A r s y e t i m

Paditësi KEDS Sha me seli në P, përmes të autorizuarës së tij në procesverbal në seancën e datës 16.06.2024 e njofton gjykatën që me palën e paditur në këtë çështje kontestimore në tërsi ka kompenzuar dëmin me datën 18.05.2024. Gjykatës i ka dorëzuar si provë transakcionin e konsumatorit e datës 18.06.2024. Për këtë arsye deklarohet se heq dorë nga kërkesëpadinë në këtë çështje kontestimore, për borgjin , ndërsa ka kërkuar shpenzimet për taksen gjyqësore prej 60€ .

Pasi që paditësi, ka hequr dorë nga kërkesëpadia në këtë çështje kontestimore, gjykata në kuptim të nenit 149 par. 1 të LPK-së, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u mor konform nenit 452 par.1 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,
C.nr.624/20 dt.19.06.2024

Gjyqtari
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.